



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 26
Prishtinë, më 20.1.2009, ora 13:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri - kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujoviq, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti, Drita Maliqi, Shpresa Murati, Naim Rrustemi dhe Vezira Emrush – anëtarë.

Të ftuar: ministri i Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti dhe këshilltarët e tij, si dhe përfaqësuesit e Divizionit të Sigurimit Policor.

Mbledhjen e monitoruan: nga OSBE-ja, Lejla Selimi dhe Megan Kassiakoff, nga DSPK-ja, Enver Ajeti, nga OHCHR-ja Xhemajl Ahmeti, nga "Bota sot" Ramiz Bojaj, Besnike Salihu "Kosova Live", Adrian Çollaku "Zëri" dhe Ardian Thaçi KTV, RT-21, RTK.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Sulltane Gashi dhe Rrahim Demaj – koordinators, zyrtar i lartë ligjor.

Për këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i t e

- 1 Takim me ministrin e Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti, me qëllim të shqyrtimit të petitionit të nënshkruar nga një grup oficerësh dhe rreshterësh të Divizionit të Sigurimit Policor të Kosovës,
- 2 Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1 Takim me ministrin e Punëve të Brendshme, Zenun Pjaziti, me qëllim të shqyrtimit të peticionit të nënshkruar nga një grup oficerësh dhe rreshterësh të Divizionit të Sigurimit Policor të Kosovës

Ismet Beqiri, kryetar - Në fillim i përshëndeti ministrin dhe të tjerët që iu kishin përgjigjur ftesës. I njoftoi për punën e Komisioni në zgjedhjen e peticioneve. E ceku peticionin e një grupi oficerësh dhe rreshterësh të Divizionit të Sigurimit Policor të Kosovës. Kërkoj nga përfaqësuesit e peticionit, që kohë më parë ishin të pranishëm në seancën e këtij komisioni, ta merrnin fjalën dhe ta paraqitnin një informatë të shkurtër për përmbajtjen e tij. Në fund, para se t'ua jepte fjalën të tjerëve, theksoi se qëllimi i këtij takimi ishte të gjendej një zgjidhje për këtë çështje, sepse ky ishte shqetësim edhe për ministrin, edhe për Kuvendin, meqë numri i nënshkruesve është i madh.

Mërgim Bektashi – Përfaqësues i peticionit, e falënderoi Komisionin që ia ka mundësuar të jetë i pranishëm në mbledhje për t'i paraqitur shqetësimet e cekura në peticion. Njëherësh kërkoj që ato të zgjidhen në përputhje me ligjin. Ne i kemi plotësuar edhe me gojë, edhe me shkrim të gjitha kriteret e parapara me konkurs. E kemi plotësuar edhe testin psiko-fizik. Në bazë të kësaj është krijuar Divizioni për Sigurimin e Objekteve Institucionale, si: Presidenca, Kuvendi, Qeveria dhe ministritë e saj. Pra, e kemi respektuar hierarkinë komanduese të SHPK-së dhe kemi krijuar kulturë të sjelljes ndaj deputetëve dhe personave të autorizuar shtetërorë. Qeveria e Kosovës, në bazë të vendimit nr. 04/30, të 19. 08. 2008, e ka ndryshuar statusin e oficerëve të Sigurimit të Policisë së Kosovës në zyrtarë policorë. Për këtë jemi mirënjohës. Gjithashtu mjetet financiare për vitin 2008 do të sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme, kurse për vitin 2009 do të planifikohen me procedurë të rregullt buxhetore. Ministria do të kujdeset për zbatimin e vendimit që nga hyrja e tij në fuqi. Kërkesat e tyre janë: njohja dhe trajnimi i përvojës policore, njohja dhe pranimi i gradave dhe nivelizimi i pagave me njësi të tjera.

Ministri i Punëve të Brendshme, Zenun Pjaziti - Tha se kryeministri ka marrë vendim në gusht të 2008-s që oficerët e Sigurimit Policor të shndërrohen në policë. Në vazhdim shtoi se ka mundur të ketë keqinterpretim për këtë rast, ngase është nënkuptuar që ky proces do të jetë më i shpejtë. Vendimi i Qeverisë ka qenë në përputhje me përgatitjet e mëdha që janë bërë brenda Ministrisë dhe Policisë. Janë krijuar disa standarde të veçanta për trajnime për këtë kategori. Ju e dini që për t'u bërë polic është një shkallë tjetër e trajnimeve. Oficerëve të sigurimit nuk mund t'u njihet përvoja e punës si zyrtarë ligjorë, për arsye se trajnimi i tyre nuk ishte adekuat dhe në pajtueshmëri me ligjin. Pa përfunduar trajnimi bazik nuk mund të bëhet nivelizimi i pagave. Njoftoi, po ashtu, se grupi i parë i oficerëve të sigurimit të tashëm i ka kryer trajnimet e nevojshme për të qenë pjesëtarë të policisë, por dinamika e trajnimeve të tyre nuk po shkon shpejt, sepse janë të angazhuar në sigurimin e objekteve. Vuri në pah se ka kërkuar nga drejtori i Shërbimit Policor të Kosovës të përshpejtohet trajnimi për këta oficerë dhe shprehu bindjen se për një kohë do të bëhen të gjithë pjesëtarë të policisë.

Naim Rrustemi – Duke u ndërlidhur me këtë çështje i kërkoj Komisionit të përqendrohet në peticion e jo në arsyshmerinë e tij. Qeveria para se ta nënshkruante e ka vlerësuar arsyshmerinë e tij, prandaj tani kërkohet të dihet, pse nuk po zbatohet vendimi. Qeveria e Kosovës, në bazë të vendimit nr. 04/30, të 19. 08. 2008, e ka ndryshuar statusin e oficerëve të Sigurimit të Policisë së Kosovës në zyrtarë policorë. Kalimi i tyre duhet të bëhet automatikisht. Vendimi është i bazuar edhe në dispozitat e Ligjit për policinë. Çështja e pagesave nuk ka dilema, sepse është problem i Qeverisë

dhe se kryeministri, para se të merrte vendim, i ka pasur këto parasysht. Në fund kërkoi nga kryetari i Komisionit që diskutimet të përqendrohen vetëm për moszbatimin e vendimit e jo në pamundësinë e zbatimit të tij.

Ibrahim Makolli – Duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësit, që e mbështeti, tha se vendimi i Qeverisë së Kosovës e ka ndryshuar statusin e tyre, duke i trajtuar ata si zyrtarë të policisë. Ai tha se në peticion janë ngritur disa çështje, siç janë mosnjohja e përvojës, gradat, pagat dhe trajnimet. Kërkoi përgjigje dhe ofroi arsyeshmëri. Edhe pse ky divizion ishte pjesëtar i Shërbimit Policor, tani është viktimë e ndërtimit të këtyre mekanizmave. Kjo ka ndodhur në një kohë, kur nuk i kanë pasur parasysht pasojat. Ai kërkoi të zbatohet vendimi i Qeverisë së Kosovës.

Prof dr. Nerxhivane Dauti – U pajtua me diskutimet e deputetëve Naim Rustemi dhe Ibrahim Makolli. Tha se në legjislaturën e parë ka hasur në një peticion të tillë. Duke u solidarizuar me oficerët e Divizionit, për ta gjetur një modus të përbashkët për zgjidhjen të kërkesave të tyre, i shtroi disa pyetje dhe kërkoi të jepet përgjigje: Pse nuk u njihet përvoja e punës? Pse nuk u pranohen gradat? Pse nuk u caktohet vendi i punës? A kërkohet trajnim shtesë apo bazik?

Hajredin Hyseni - Pyeti sa prej grupit të dërguar e kanë kaluar testin dhe a bëhet fjalë për trajnime shtesë apo bazike ?

Pyetjeve të shtruara iu përgjigjën ministri dhe stafi i tij, disa prej tyre i dorëzuan me shkrim.

Drita Maliqi – U pajtua me shumicën diskutuesve. Kërkoi sërish informim lidhur me trajnimet, si dhe pyeti se sa prej këtyre pjesëtarëve janë inkorporuar në Shërbimin Policor të Kosovës.

Vezira Emrush – U angazhua për ndriçimin e rrethanave të transformimit të këtij Divizioni, ngase po shihet se ndërmjet Qeverisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme ka kundërtënie në interpretimin dhe zbatimin e vendimit. Kërkoi që kjo çështje të zgjidhet pa pasoja, sepse me largimin e 493 pjesëtarëve të këtij divizioni hapen probleme sociale për familjet e tyre, gjë që nuk e dëshirojmë.

Në mbledhje u zhvillua një debat i gjerë përkitazi me këtë problematikë.

Ismet Beqiri - Në përmbyllje ceku se vendimi për t'u kthyer në policë zyrtarë ka shkaktuar pakënaqësi të caktuara dhe në praktikë nuk mund të zbatohet. Theksoi se 493 pjesëtarëve, që kanë punuar me uniformë, nuk mund t'u thuhet se nuk kemi nevojë për ta. Shtoi se në takimin e radhës do të marrim rekomandime përkatës si komision.

Konstatim i përgjithshëm ishte që kërkesat e nënshkruesve të peticionit të zgjidhen në të mirë të tyre dhe në suaza ligjore.

Në fund kryetari i falënderoi pjesëmarrësit për kontributin që e dhanë.

Komision nuk debatoi për pikën e dytë.

Mbledhja përfundoi në orën 15: 00.

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri